

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

Datë: 27.09.2024

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 26.09.2024, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 1667, të datës 04.09.2024, paraqitur nga Drejtoria e Financave dhe Buxhetit, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (d), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (b), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 61, paragrafi 61.2, të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi Nr. 03/L-048, nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (ç), nenin 27, shkronja (c), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M


Për aprovimin e Buxhetit të Planifikuar të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2025

1. Për aprovimin e Buxhetit të Planifikuar të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2025, në shumë të përgjithshme prej 16,747,838.00€, i shpërndarë nëpër programe e nën-programe të kategorive ekonomike si vijon:
 - 1.1 Për paga dhe mëditje për 1040 të punësuar në Administratën Komunale, Arsim dhe Shëndetësi, buxheti i komunës është në shumë prej: 8,620,214.00€;
 - 1.2 Për mallra dhe shërbime, buxheti i komunës është në shumë prej: 2,125,968.00€;
 - 1.3 Për shpenzime komunal, buxheti i komunës është në shumë prej: 350,000.00€;
 - 1.4 Për subvencione e transfere, buxheti i komunës është në shumë prej: 1,298,675.00€;
 - 1.5 Për shpenzime në projekte kapitale, buxheti i komunës është në shumë prej: 4,352,982.00€.
2. Vlerësimet e hershme të caktuara me kufijtë për Buxhetin e Planifikuar me Kornizën Afatmesme Buxhetore për vitin fiskal 2026, është në shumë të përgjithshme prej: 17,592,179.00€ dhe për vitin fiskal 2027, është në shumë të përgjithshme prej: 18,456,253.00€.
3. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera, mbështetur në tabelat buxhetore për Buxhetin e vitit 2025 për secilën kategori ekonomike të shpenzimeve, të planifikuara dhe të përshkruar në paragrafin një dhe dy të këtij vendimi dhe zbatim i tij, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së FB, Drejtorive të Komunës dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Ali Ismaili



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

Datë: 27.09.2024

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 26.09.2024, pas shqyrtimit të Kërkesës me Nr. 36217, të datës 23.09.2024, të Këshillit Bashkiak të Bashkisë së Tiranës për lejin e vizitës zyrtare në Republikën e Shqipërisë, për anëtarët e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, në Këshillin Bashkiak të Tiranës, bazuar në nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (c), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, shkronja (ç), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M


Për lejin e vizitës zyrtare në Këshillin Bashkiak të Bashkisë së Tiranës në Republikën e Shqipërisë

1. Për lejin e vizitës zyrtare në Republikën e Shqipërisë në muajin nëntor 2024, e lidhur me ftesën e Bashkisë së Tiranës - Këshillit Bashkiak të Tiranës.
2. Organizimi i vizitës zyrtare bëhet nga data: 03-06.10.2024, sipas ftesës zyrtare të Këshillit Bashkiak të Tiranës Nr. 36247, të datës 23.08.2024.
3. Sigurimi i mjeteve financiare për realizimin e vizitës zyrtare në Këshillin Bashkiak të Tiranës dhe kryerja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së FB dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Ali Ismaili



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

Datë: 03.10.2024

Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më datë 26.09.2024, pas shqyrtimit të 'Projekt-Planit të Veprimit për parandalimin e braktisjes dhe mos - regjistrimit në shkolla për vitet 2024 - 2026, në të gjitha shkollat e Komunës së Fushë-Kosovës', të paraqitur nga Drejtoria e Arsimit, i shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetit për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (d), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (ç), nenin 27, shkronja (nj), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M


Për aprovimin në parim për diskutim publikë të Projekt-Planit të Veprimit për parandalimin e braktisjes dhe mos - regjistrimit në shkolla për vitet 2024 - 2026

1. Për aprovimin në parim për diskutim publikë të Projekt-Planit të Veprimit për parandalimin e braktisjes dhe mos - regjistrimit në shkolla për vitet 2024 - 2026, në të gjitha shkollat e Komunës së Fushë-Kosovës.
2. Projekt-Planit të Veprimit për parandalimin e braktisjes dhe mos - regjistrimit në shkolla për vitet 2024 - 2026, në të gjitha shkollat e Komunës së Fushë-Kosovës, parasheh zhvillimin e punëve dhe aktiviteteve për parandalimin e braktisjes së shkollës.
3. Pjesë përbërëse e 'Projekt-Planit të Veprimit për parandalimin e braktisjes dhe mos - regjistrimit në shkolla për vitet 2024 - 2026'.
4. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi për mbajtjen e diskutimit publik, është kompetencë e Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë së Arsimit.
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së Arsimit dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Ali Ismaili



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

Datë: 03.10.2024

Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më datë 26.09.2024, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 1839, të datës 16.09.2024, të paraqitur nga Kryetari i Komunës, i shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetit për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (c), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (a, l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 24, të Rregullores së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 06/2024, për klasifikimin e vendeve të punës në Shërbimin Civil, nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (c), nenin 27, shkronja (b, nj), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M


Për aprovimin në parim për diskutim publikë të Projekt-Rregullores për Organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Administratën Komunale

1. Për aprovimin në parim për diskutim publikë të Projekt-Rregullores për Organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Administratën Komunale’.
2. Projekt - Rregullorja për Organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Administratën e Komunës së Fushë-Kosovës’, parasheh mënyrën e organizimit dhe rregullimin e brendshëm, përgjegjësit e njësive organizative si dhe sistematizimin e vendeve të punës në administratën komunale, përfshirë administratën e shërbimit publik dhe organogramin e komunës.
3. Pjesë përbërëse e ‘Projekt - Rregullorës për Organizimin e brendshëm është Klasifikimi dhe sistematizimi i vendeve të punës dhe Organogrami i Administratës Komunale’.
4. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi për mbajtjen e diskutimit publik, është kompetencë e Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë së Administratës.
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së Administratës, Drejtorive tjera Komunale dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Ali Ismaili



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVËS/KOSOVO-POLJE



Datë: 03.10.2024

Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më datë 26.09.2024, pas shqyrtimit të shkresës Nr. 020-7/10, të datës 15.08.2024, për vendimin Nr. 104, të datës 02.08.2024, të kthyer në rishqyrtim nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në lidhje me ndërrimin e anëtarit në përbërjen e Komitetit për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (e), nenin 51, paragrafi 51.1, nenin 53, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 3, paragrafi 1 dhe 2, nenin 7, nenin 8, nenin 9, paragrafi 4, të Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2020, për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve tjera në Komunë, nenin 27, shkronja (e), nenin 34, paragrafi 34.1, shkronja (b), 34.4, nenin 36, nenin 38, të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për rishqyrtimin e vendimit Nr. 104, të datës 02.08.2024 dhe bën ndryshim - plotësimin e vendimit Nr. 200, të datës 29.12.2021 me zëvendësimin e dy anëtarëve të Komitetit për Komunitete

1. Për rishqyrtimin e vendimit Nr.104, të datës 02.08.2024 dhe ndryshim - plotësimin e paragrafit 1, nën-paragrafit 1.7, të vendimit Nr. 200, të datës 29.12.2021, për themelimin e Komitetit për Komunitete për të realizuar ndërrimin e përfaqësuesit të Komitetit Egjiptian, duke e larguar znj. Linda Hyseni nga përbërja e Komitetit për Komunitete prej nëntë anëtarëve dhe për caktimin e z. Bashkim Kransiqi në cilësinë e anëtarit të ri të Komitetit për Komunitete.
2. Me rishqyrtimin e vendimit Nr.104, të datës 02.08.2024 dhe ndryshim - plotësimin e paragrafit 1, nën-paragrafit 1.2, të vendimit Nr. 200, të datës 29.12.2021, për themelimin e Komitetit për Komunitete për të realizuar ndërrimin e përfaqësuesit të Lidhjes Demokratike të Kosovës, duke e larguar znj. Arjeta Jashari nga përbërja e Komitetit për Komunitete prej nëntë anëtarëve dhe për caktimin e znj. Vjollca Konjusha në cilësinë e anëtares së re të Komitetit për Komunitete.
3. Ky vendim është pjesë përbërëse e vendimit Nr. 200, të datës 29.12.2021, për themelimin e Komitetit për Komunitete në Komunën e Fushë-Kosovës, i cili është përgjegjës për shqyrtimin e përputhshmërisë së autoriteteve komunale me ligjin në zbatimin dhe shqyrtimin e të gjitha politikave komunale, praktikave dhe aktiviteteve për t'u siguruar se të drejtat dhe interesat e komuniteteve respektohen plotësishtë. Komiteti gjithashtu i rekomandon Kuvendit të Komunës, masat që duhet të ndërmerren për të siguruar jetësimin e dispozitave që kanë të bëjnë me nevojën e komiteteve për tu avansuar, shprehur,

mbrojtur dhe zhvilluar identitetin e tyre etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësor, si dhe për të siguruar mbrojtje adekuate të drejtave të Komuniteteve brenda Komunës.

4. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Financave e Buxhetit dhe Udhëheqëses së Personelit.
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës dhe pas shqyrtimit të shkresës Nr. 020-7/10, të datës 15.08.2024, i kthyerë në rishqyrtim nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në lidhje me ndërrimin e anëtarit në përbërjen e Komitetit për Komunitete, e bënë shfuqizimin e vendimit Nr. 104, të datës 02.08.2024.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës,
Drejtorisë së FB, Anëtarëve të Komitetit për Komunitete,
Udhëheqëses së Personelit dhe Arkivës.**

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Ali Ismaili**

